Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës

Drejtoria për Administratë dhe Personel
Zyra e Prokurimit
Nr 03/ 25
Datë 07.04.2023

# KONTRATË PROKURIMI Nr 20

**Komuna e Malishevës**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;
dhe
**„Kater A Sh.P.K" Prishtinë me Nr biznesi 810035297** (ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

FURNIZIM ME KARRIGE PËR STAF TË ADMINISTRATËS SË KK-MALISHEVË **me numër identifikues: 62500-22-12508-1-2-1**

**Neni 1 Lënda**

1.5 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizzimeve në vijim nga ana e Kontraktuesit:
**Furnizim me karrige për staf të administratës në Komunën e Malishevës.**

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total është : **29 ,670.00€ (njëzetëenëntëmijëegjashtëqindëeshtatëdhjetëeuro).**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.7 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 4** **Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në katëra origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues** **Për Operatorin Ekonomik**

| **Emri:** | Nuhi Shalaj | **Emri:** | **Arsim Selimi** |
|---|---|---|---|
| Pozita: | Menagjer i Prokurimit | Pozita: | **Drejtor** |
| Nënshkrimi: | [signature] | Nënshkrimi: | [signature] |
| Data: | | Data: | 07.04.2023 |
| **Vula:** | [stamp] | **Vula:** | [stamp: "Kater A" SH.P.K Prishtinë] |

# KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|---|---|---|
| Përshkrimi i nenit | Nr. Nenit | |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë. |
| | 2.2 | **Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE** |
| Siguria e ekzekutimit | 9.1 | **10% e vleres së kontrates .** |
| Sigurimi | 10.1 | *[Specifikoni kërkesat specifike të sigurimit]* |
| Programi i ekzekutimit | 11 | |
| Tatimet dhe marrëveshjet doganore | 12.1 | **Të gjitha i perkasin OE** |
| Menaxheri i kontratës | 13.1 | **Menaxhimi i kontrates do të bëhet nga zyrtari i DKA-së z.Sabit Berisha i caktuar me vendim nga ZKA i AK-së.** |
| Pranimi i furnizimit | 14.1 | **Pranimi i furnizimit me karriga do të behet nga një komision i caktuar nga ZKA i AK vetem mbas testimit te tyre.** |
| Cilësia e furnizimeve | 18.2 | **Karrigat duhet të jetë në cilësi të kerkuar sipas specifikacionit te ofertës.**<br>**Nese karrigat nuk janë në cilesi dhe sipas specifikave te cekura ne specifikacionin e ofertës do të i kthehen OE dhe shpenzimet e bera do të bien në llogari të OE.** |
| Pagesa | 20.1 | **Obligohet AK që mbasi ta e pranon raportin per pranim të karrigave nga komisioni perkates i caktuar nga ZKA i AK dhe faturen së bashku me fletëdergesa nga operatori ekonomik të ia paguaj shumen sipas nenit 2 dhe 2.1 të kesaj kontrate.** |
| Dorëzimi | 21.3 | **Furnizimi me karriga do të kryhet në afatë prej njëzetë (20) ditësh që nga dita e nënshkrimit të kontratës.** |
| Vonesat në ekzekutim | 24.1 | **Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të e kryej furnizimin brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së** |

| | | |
|---|---|---|
| | | **furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.** |
| Obligimet e garancionit | 24.2 | **Karrigat kan garancion tridhjetëegjashtë (36) muaj nga dita e pranimit nga komisioni i caktuar nga ZKA i AK.** |
| Shërbimet pas shitjes | 25.1 | *[Jepni detajet e shërbimit pas shitjes që Furnizuesi duhet të siguroj dhe përcaktoj raportin e sigurisë së ekzekutimit të caktuar për këtë aktivitet]* |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes | 31.2 | *[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]* |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore | 32.1 | *[shëno te dyja]*<br><br>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet *[specifikoni gjykatën kompetente]* në pajtim me ligjin në Kosovë.<br><br>ose<br><br>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me *[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].* |

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA MALISHEVË
DREJTORIA PER ADMINISTRATE TE PERGJITHSHME

## Furnizim me karrige për staf të Administratës së KK-Malishevë

| Nr. | Përshkrimi | Njësia matese | Sasia | Çmimi për njësi pa TVSH | TVSH | Çmimi për njësi me TVSH | Çmimi total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | <br><br>Ngjyra e lëkures Industriale<br>**Karrige Statike**<br>Karrika duhet të jetë minimum gjatësia nga toka 90 deri 92cm, gjerësia mimimum 54 deri 56cm, thellësia minimum 58 deri 62cm<br>Materiali i mbështjellur duhet të ofrohet nga lëkura Antracit<br>Këmbët e karriges duhet të jenë nga metali gypi formë ovale e ngjyrosur në mënyrë elektro statike ngjyra antracit RAL 7021<br>Dorëzat duhet të jenë të mbuluara me plastikë për të evituar kontaktin direkt me metalin<br>Densiteti i shpuzes duhet të jetë minimum 42 dns e konfirmuar nga prodhuesi e nenshkruar dhe vulosur për AK<br>Për këtë artikull duhet të sillet mostra | Copë | 15 | 125.42 € | 22.58 € | 148.00 € | 2,220.00 € |

"Kater N" SH.P.K. Prishtinë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 |   Ngjyra e Uleses  Ngjyra e Rrjetes | **Karrige Lëvizëse Ergonomike**<br>Karrika duhet të jetë minimum gjatësia nga toka 120 deri 123 cm, gjerësia mimimum 64 deri 66cm, thellësia minimum 62 deri 64cm<br>Ulësja e karriges duhet të ofrohet nga materiali polyertene cast foam i mbështjellur nga bezi me bazë fleksibile ngjyrë të zezë.<br>Shpina dhe koka e karriges duhet të jenë me rrjetë ngjyrë hiri të mbyllitë<br>Pjesa e shpines për shkak të fortësisë duhet të ketë shtyllë metali e cila ngjitet ne bazen e Karriges<br>Karriga duhet te ofrohet me yll pesë këmbë me diameter prej 65 cm<br>Dorëzat duhet të jenë nga plastika e zezë me mundë ngritje poshtë lartë<br>Karriga duhet të ketë nivelin 4 te gasliftit sipas standardit Europian EN-16139<br>Për këtë artikull duhet të sillet mostra | Copë | 93 | 211.86 € | 38.14 € | 250.00 € | 23,250.00 € |
| 3 |   Ngjyra e lëkures Industriale | **Ulëse per 4 persona pritje**<br>Karrika duhet të jetë minimum gjatësia nga toka 78 deri 80 cm, gjerësia mimimum 228 deri 232cm, thellësia minimum 57 deri 60cm<br>Ulësja duhet të ketë pjesë të ngjitura njëra pas tjetrës 4 copë me material polyertene cast foam Baza e ulëses duhet te jetë nga metali me tre kembe ne forme trekëndësi të ngjitura ne nje shtyllë horizontale katerore e ngjyrosur me metode elektrostatike ngjyrë antracit RAL 7021<br>Materiali i mbështjellur duhet të ofrohet nga lëkura Antracit | Copë | 6 | 593.22 € | 106.78 € | 700.00 € | 4,200.00 € |
| TOTALI | | | | | | | | 29,670.00 € |

"Kater A" SH.P.K. Prishtinë